



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0599

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

**NTP 'T 'në Prishtinë, , të cilën e përfaqëson Av. N Th nga Prishtina,
*kundër***

E paditura

**Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë,
Prishtinë**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-15-0104 të datës 12 tetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 tetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktvendimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-15-0104 të datës 12 tetor 2022.**
- 3. Lënda kthehet në rishqyrtim në Shkallën e I-rë të DHPGJS-së tek gjyqtari përkatës.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 05 shkurt 2015, paditësi e dorëzoi ne DHPGJS një padi për kompensim të borxhit në emër të fitimit të humbur në shumen prej 50.850, 00€. Paditësi në padi ka theksuar se posedon Memorandumin e datës 21 qershor të vitit 2021, ku sipas nenit II, pika 5 të tij, AKM-ja është obliguar që brenda 5 ditëve të bëjë largimin e dokumentacionit të ndërmarrjes shoqërorë nga lokalet e kompanisë re. AKM-ja dhe pas ardhësja e saj tash AKP-ja, nuk kanë bërë lirim të lokalit, dhe nuk ka bërë as pagesat e borxhit për fitimin e humbur për 113 muaj, në shumën 50.850,00€. Paditësi ka kërkuar të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj paditësit borxhin kryesor në shumën 50850€, tatimin në qira 9%, dhe TVSh 16 %, në shumën 8, 868.24€, ose totalin e shumës prej 64,294.74€, me kamate prej ditës së paraqitjes së padisë. Paditësi se bashku me padinë ka dorëzuar Kërkesën për pagesën e shfrytëzimit të objektit të Ndërmarrjes së R U **ShPK**, te datës 18.11.2014, Dokumenti Memorandum interno te datës 21 qershor 2005, Kërkesë për lirim të lokalit te datës 22.08.2005, Fatura nr. 35/14-1, dt. 18.11.2014, Kërkesë për pagesë të qirasë për shfrytëzimin e objektit te datës 05.09.2013, Ekspertiza e hartuar nga eksperti R B mbi vlerësimin e fitimit të humbur te datës 25.06.2020.

Më date 10 gusht 2020, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dhënë përgjigje në padi. AKP-ja e ka kundërshtuar padinë e paditësit si të pa bazuar. Në mbrojtje në padi, AKP-ja ka deklaruar se në kuptim të nenit 399 .2 të LPK-së, faktet në të cilat mbështetet padia janë në kundërshtim me provat të cilat i ka prezantuar paditësi. Kjo për faktin se paditësi pretendon se ekziston raporti i qirasë, ndërsa dëshmitë e paraqitura në padi dëshmojnë krejt diçka tjetër. Më tej AKP-ja ka theksuar se dokumenti „M ” në të cilën thirret paditësi është një dokument që është lëshuar me rastin e shitjes së asetit në fjalë, të cilin e ka blerë vetë paditësi. Kjo M nuk është kontratë e qirasë, mirëpo ka karakter informimi për blerësin që nënkupton detyrimin e blerësit të ri në caktimin e një agjenti të regjistruar, ndërrimin e

aksioneve të kompanisë, adresa e kompanisë së re, si dhe çdo regjistrim tjetër që mund të kërkohet në ARBK.

Me date 19 gusht 2020, shkalla e I-rë e DHPGJS-se, ka lëshuar për paditësin një Urdhër dhe është kërkuar që paditësi të bëjë plotësimin e padisë për borxhin e pretenduar. Në Urdhër paditësi është njoftuar me pasojën juridike të mos veprimit.

Me date 28 gusht 2020, paditësi ka dorëzuar në DHPGJS dy parashtresa, dhe atë : parashtresën si përgjigje në padi, dhe parashtresën e dytë me të cilën e ndryshon padinë dhe e plotëson padinë. Me këtë parashtresën e dytë, paditësi kërkon lirimin e lokalit dhe kompensimin e fitimit të humbur. Në këtë parashtresë paditësi kërkon që të detyrohet e paditura, t' ia liroi lokalin si dhe t' ia paguaj shumën prej 59,526.63€, si shpërblim i dëmit të pretenduar në emër të fitimit të humbur, si pengese për shfrytëzimin e pjesës së zyrave administrative të ndërtesës në sipërfaqe 115m². Me këtë parashtresë paditësi ka bashkangjitur Certifikatën e pronës, Kopjen e planit, Marrëveshjen për shitjen e aksioneve në mes AKM-së dhe NPTT, T, Ekspertizën financiare të nxjerr nga eksperti R B , dhe provat tjera të cilat i kishte dorëzuar me padi .

Me date 11 shtator 2020, AKP-ja me parashtresën e saj, është deklaruar në lidhje me ndryshimin dhe plotësimin e padisë. Në këtë parashtresë AKP-ja ka pohuar se paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë apo fakt të ri për të cilat Agjencia do të duhej për tu deklaruar, dhe ka mbetur pranë pretendimeve të mëhershme të dhëna në përgjigje në padi. AKP-ja në këtë parashtresë ka pohuar se nuk është kontestuese fakti se paditësi është blerës i pronës në fjalë, sikur që nuk është kontestuese as fakti që NSH-ja kishte disa dokumente të saj në hapësirë e objektit të blerë. AKP-ja pohon se nuk kishte pse të shfrytëzonte atë pjesë të lokalit në sipërfaqe 115m². Tutje AKP-ja pohon se ajo pjesë e arshivës të ndërmarrjes nuk është aq voluminoze sa që të zë këtë sipërfaqe prej 115 m² siç pretendon paditësi. AKP-ja pohon se vet fakti se prona e blerë e ndërmarrjes, është bart tek blerësi që nga viti 2005, tregon se nuk ka mbetur asgjë pa u realizuar.

Tutje AKP-ja pohon se ajo vazhdimisht kishte kërkuar nga paditësi që ta tërheq atë pjesë të arkivit të ndërmarrjes nga lokalet ndërmarrjes, mirëpo paditësi e ka kushtëzuar tërheqjen me pagesën e qirasë. Me këtë parashtresë AKP-ja ka dorëzuar, parashtresën e saj drejtuar për paditësin me date 25 janar 2018.

Me datë 08 tetor 2020, Shkalla e I-re e DHPGJS-se ka lëshuar Urdhër për paditësin, me të cilin i është kërkuar paditësit të plotëson padinë, pasi konsideron se nuk kishte vepruar sipas urdhrit të datës 19 gusht 2020, që ka të bëjë me identifikimin e saktë të lokalit kontestues me të gjitha të dhënat gjeodezike .

Me date 19 tetor 2020, paditësi si përgjigje ndaj Urdhrit ka dorëzuar parashtresën me të cilën ai ka pohuar se e ka bërë identifikimin e palujatëshmerisë me ekspertizën gjeodezike të datës 15.10.2020. Paditësi me këtë parashtresë ka bashkangjitur ekspertizën gjeodezike e hartuar nga gjeodeti R L, si me raportin me shkrim, ashtu edhe me skiç të matjeve.

Më datë 02 nëntor 2020, Shkalla e I-rë e DHPGJS-se ka lëshuar Urdhër për AKP-në dhe për paditësin. Me këtë Urdhër për AKP-në është kërkuar të plotëson parashtresën e saj të datës 26.10.2020, për të saktësuar vërejtjet ndaj ekspertizës gjeodezike. Ndërsa me Urdhër për paditësin është kërkuar që ai të precizon kërkesën për çështje kryesore, për shkak të kundërthënieve të parashtresës së datës 28 gusht 2020, dhe të parashtresës së datës 19 tetor 2020.

Me date 04 nëntor 2020, AKP-ja ka dorëzuar parashtresën e saj, me të cilën ajo ka bërë vërejtjet e saj në ekspertizë gjeodezike, duke e quajtur këtë ekspertizë si subjektive dhe në favor të paditësit.

Me datë 06 nëntor 2020, paditësi ka dorëzuar një parashtresë lidhur me dy parashtresat e tij me të cilën është deklaruar në pretendimet e AKP-së. Ai pohon se sipas parashtresës së datës 26 tetor 2020, ka bërë precizimin e kërkesëpadiisë dhe ka kërkuar të detyrohet e paditura që paditësit t' ia liroj lokalin në sipërfaqe prej 115 m² dhe e paditura t' ia bëjë kompensimin e fitimit të humbur si rrjedhojë

e pamundësisë së shfrytëzimit të kësaj pjese së zyrave administrative, për periudhën prej datës 25.05.2005 nga dita e blerjes së ndërmarrjes e deri në pagesën definitive, duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit financiar, në shumën prej 99, 526.65€ me kamat ligjore .

Me date 09 dhjetor 2020, shkalla e I-re e DHPGJS-së ka lëshuar edhe një Urdhër për paditësin, duke i kërkuar përsëri të plotëson padinë me kërkesën që ndërlidhet me objektin kontestues si dhe në pjesën për kërkesën për çështje kryesore rreth borxhit të pretenduar.

Me date 14 dhjetor 2020, paditësi ka dorëzuar një parashtresë në DHPGJS si përgjigje ndaj Urdhrit dhe është deklaruar se në lidhje me objektin e kërkesëpadisë, kërkesat e tij janë kompensimi i dëmit të fitimit të humbur dhe përmbushja e memorandumit të datës 21 qershor të vitit 2005. Në këtë parashtresë paditësi ka kërkuar përsëri të detyrohet e paditura t' ia paguaj paditësit kompensimin e fitimit të humbur për periudhën kohore prej memorandumit të datës 21 qershor 2005 të AKM-së / AKP-së, e deri në vendosjen e gjykatës sipas ekspertizës financiare për vlerën mujore 441.00€, apo në shumën totale prej 99, 526.65€, me kamat ligjore 8%, në emër të shfrytëzimit të zyrave administrative në sipërfaqe prej 115 m², në ngastrën kadastrale 01499-7, Zona Industriale Prishtinë .

Me datë 15 shkurt 2022, Kolegji i Shkallës së I-rë të DHPGJS-se ka caktuar seancë dëgjimore lidhur me padinë. Në seancë dëgjimore i autorizuari i paditësit av. N Th i cili edhe kishte precizuar padinë me parashtresë datës 14.12.2020, ai përveç kërkesës për kompensim e dëmit në emër të fitimit të humbur e paraqet edhe kërkesën për lirim të pronës. Për shkak të kësaj rrethane Gjyqtari individual, e ndërpreu procedurës, me arsyetim se bëhet fjalë për kërkesë pronësore, dhe përbërja e gjykatës në çështjet pronësore është paraparë të jetë me kolegji, prej tre gjyqtarëve, siç parasheh neni 21, paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/- 86, dhe seanca dëgjimore është ndërprerë .

Me datë 07 mars 2022, Kolegji i Shkallës se I-rë përsëri për paditësin ka lëshuar Urdhër, për precizimin e pjesës së kërkesës për lirim e pronës, duke i kërkuar precizimin e saktë të kërkesën për lirim e pronës kontestuese duke i kërkuar të gjitha të dhënat gjeodezike, siç është identifikuar nga eksperti i gjeodezisë .

Me datë 25 mars 2022, paditësi ka dorëzuar parashtresën e fundit me të cilën ka precizuar kërkesën e tij. Në këtë parashtresë paditësi ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësit t' ia liroj pronën e uzurpuar, duke u bazuar në raportin e ekspertizës gjeodezike, në objektin që ndodhet në parcelën P- 71914059-01499-7, Zona Kadastrale në Prishtinë. Në këtë parashtresë ka kërkuar lirim e sipërfaqes së objektit prej 115m2, dhe largimin e dokumenteve arkivore të ish ndërmarrjes shoqërore.

Me datë 12 tetor 2022, Kolegji i Shkallës se I-rë i DHPGJS-së me Aktvendimin C-III-15-0104, e hedh poshtë si të pa pranueshme pjesën e kërkesëpadsisë se paditësit me të cilën është kërkuar që e paditura ta liroj pronën e uzurpuar sipas raportit të ekspertizës gjeodezike në objektin që ndodhet në ngastrën P-7191-4059-01499-7 ZK Prishtinë, në sipërfaqe prej 115 m2 si dhe largimi i dokumentacionit arkivor të ndërmarrjes nga lokalet e kompanisë se re.

Me këtë Aktvendim , Kolegji i Shkallës se I-rë të DHPGJS-së ka vendosur që për pjesën tjetër të kërkesëpadsisë që ndërlidhet me kompensim dëmi, do të vendoset në merita .

Kolegji i Shkallës se I-rë ka arsyetuar se paditësi, pjesën e kërkesëpadsisë për lirim e pronës, ashtu siç e ka precizuar me parashtresë datës 25.03.2022 ka të meta për shkak se nuk ka përfshirë të gjitha të dhënat gjeodezike, për identifikimin e paluajtshmërisë për të cilën është kërkuar lirimi. Në të vërtetë eksperti i gjeodezisë me rastin e hartimit të raportit gjeodezik me shkrim më datës 15.10.2020, ka bërë identifikimin objektit të ndërtuar në ngastre P – 71914059- 01499-7, e cila ngastër është e regjistruar në emër të N' 'U" LLC e marrë në shfrytëzim si qira mbajtje 99 vite nga NPT 'T " SHPK. Ngastra

kadastrale është në zonë rurale, ka sipërfaqe 27 ari e 14 m², me kulturë arë e klasës së dytë. Objekti ndodhet në Zonën Kadastrale në Prishtinë, dhe ka sipërfaqe 360m², ndërsa pjesa e objektit kontestues, ka sipërfaqe 115m². Në raport është bashkangjitur edhe skica e majtëve me të cilën është skicuar ngastra nr. 1499-7, sikundër edhe objekti ndërtimor, dhe atë me matje gjeodezike me metra dhe me koordinata. Sipas skicës së matjes gjeodezike, sipërfaqja totale e objektit është 360 m², të ndërtuar në ngastrën nr. 01499-7, ndërsa pjesa e sipërfaqes së objektit e cila kërkohet të lirohet është me sipërfaqe 115m², Eksperti me matje si me pika dhe me metër gjatësi ka identifikuar pjesën e sipërfaqes së objektit për të cilën kërkohet lirimi e që shërben si zyre administrative e ndërtuar në pjesën e ngastrës 01499-7, dhe atë : prej pikës 1 deri në pikën 2, me gjatësi 11.47 metra, prej pikës 2 deri në pikën 3, me gjatësi 10.06 metra, prej pikës 3 deri në pikën 4 me gjatësi 11.47 metra dhe prej pikës 4 deri në pikën 1, me gjatësi 10.06 metra. Eksperti ka identifikuar me metër gjatësi edhe pjesën e objektit i cili nuk është pjesë e kërkesëpadisë. Po ashtu eksperti në skicë të matjeve ka dhënë edhe koordinatat e objektit, sipas pikave prej 1 deri në 6. Kolegji i shkallës së I-rë vlerëson se ashtu si është hartuar ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, në skicë të matjeve qartësisht është identifikuar pjesa e palujatshmerisë, për të cilën kërkohet lirimi nga paditësi dhe paditësit ju dha mundësia disa herë që ta precizon kërkesëpadinë e kjo vërtetohet me Urdhrat, që ju janë lëshuar paditësit si më lartë. Tutje Kolegji i shkallës së I-rë konstaton se paditësi përkundër faktit se ka siguruar ekspertizën gjeodezike me të cilin provë ka bërë identifikimin e pjesës së palujatshmerisë për të cilën kërkon lirimin dhe kompensimin e fitimit të humbur për shkak të mos shfrytëzimit të palujatshmerisë, paditësi me parashtresën të datës 25.03.2022, përsëri nuk vepron sipas Urdhrit të Gjykatës duke mos përfshirë të gjitha të dhënat gjeodezike për pjesën e palujatshmerisë, për të cilin kërkon lirimin e pronës. Shkalla e I-rë konstaton se ka meta për shkak se nuk janë përfshirë pjesa tjetër nga të dhënat gjeodezike e paluashtshmerisë dhe atë : matjet me pika dhe metër gjatësi, siç është identifikuar nga eksperti i gjeodezisë, që e bënë të pa përmbareshme pjesën e kërkesës për shkak të mos përfshirjes së të dhënave gjeodezike me pika dhe metër gjatësi, ose në variantin e koordinatave të objektit.

Gjykata vlerëson se paditësi është person juridik, pastaj ka të angazhuar avokat profesionistë e i cili e ka kuptuar pasojën juridike, të mos veprimet sipas Urdhrit të dt. 07.03.2022. Shkalla e I-rë konstaton se me rastin e hedhjes së pjesës së kërkesëpadisë për lirim nga prona ka zbatuar dispozitën e nenit, 36 paragrafi 2, pika 2.5 të Ligjit nr. 06/L-086, lidhur me nenin 102. 3 të LPK-së, ndërsa në pjesën tjetër të kërkesës nga kërkesëpadia për kompensim të dëmit, do të vendos në bazë të meritave, pas vazhimit të seancës dëgjimore të ndërprerë më datës 15.02.2022.

Me datë 27 tetor 2022, paditësi e ka dorëzuar një ankesë kundër Aktvendimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-III-15-0104 të datës 12 tetor 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet Aktvendimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim ose të vendoset në tërësi në merita edhe për pjesën e kërkesës kreditore në bazë të fakteve dhe provave në dosje. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë me nxjerrën e një vendimi të pjesshme në këtë rast ka shkelur nenin 182 pika n) të LPK-së pasi që Aktvendimi ka të meta, është i pa kuptueshëm dhe kontradiktor në vetvete dhe arsyetimet e Aktvendimit ndërsa ato arsyeje që janë dhënë nuk janë relevante dhe nuk ka arsyeje për faktet vendimtare në bazë të shkresave të fuqishme të lëndës, kontratën e shitblerës se pronës dhe memorandumit në mes të NTP "T" dhe AKM-së (AKP-së). Tutje në ankesë paditësi ka pohuar se në padi ka përfshirë disa kërkesa siç janë kompensimi i fitimit të humbur dhe lirimi i lokalit për periudhën siç është parapare në memorandum të datës 25 maj 2005. Paditësi pretendon se Gjykata në këtë rast ka vendosur pjesërisht për kërkesëpadinë në kundërshtim me nenin 143.2 të LPK-së kur Gjykata në këto raste vendos për të gjitha çështjet me një vendim të vetëm. Tutje paditësi pretendon se Gjykata gabimisht e ka vërtetuar edhe gjendjen faktike pasi që në arsyetimet të Aktvendimit nuk i ka theksuar shkaqet mbi faktet vendimtare paditësit është pronar legjitim i kësaj patundshmërisë në bazë të dokumentacionit autentik, certifikatës së pronës, kopja e planit dhe shkresat e tjera në dosje. Tutje paditësi pohon se parashtresa i ka të gjitha majtët me pika dhe metra bazuar në ekspertizën e ekspertit ku e thekson pjesën e objektit në

ngjyre të kuqe në sipërfaqe prej 115 m², dhe këtë sipërfaqe paditësi e ka paraqitur edhe në parashtresën e datës 25 mars 2022. Paditësi pohon se sipërfaqen prej 115 m² e kërkon që të lirohet nga e paditura andaj kjo sipërfaqe nuk është kontestuese. Nëse Gjykata nuk ishte në pajtim me kërkesëpadinë e paditësit që ka të beje me lirim e pronës të mbështetur me ekspertizën gjeodezike, atëherë Gjykata e ka të drejtën të cakton një ekspert tjetër nga lista e ekspertëve nga lista e eksperteve ete Gjykatës apo bazuar në nenin 49 të LDHP-së ,Gjykata ka pasur mundësi që të vërtetoj gjendjen faktike me daljen në teren. Për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike ,gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale bazuar në nenin 36 par.2 pika 2.5 të LDHP-së dhe nenit 102.3 të LPK-së. Paditësi pohon se përveç parashtresave për plotësim të padisë të cilat gjendjet në shkresat e lëndës, Gjykatës i ka ofruar edhe ekspertizën gjeodezike nga eksperti i licencuar ku në këtë ekspertize shihet qarte sipërfaqja e përgjithshme e objektit dhe sipërfaqja e pjesës kontestuese prej 115 m² ,ku edhe është theksuar me ngjyre të kuqe e që është e pamundur të shfrytëzohet nga pronari në këtë rast paditësi. Bashkë me këtë ankesë paditësi ka dorëzuar një plotësim të ekspertizës gjeodezike dhe disa foto të pronës kontestuese.

Me datë 12 dhjetor 2022,AKP-ja e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS-së dhe përgjigjet në ankesën e paditësit. Në këtë parashtresë AKP-së i kundërshton pretendimet ankimore të paditësit dhe mbështet në tërësi Aktvendimin e ankimuar. Ne parashtresë AKP-ja pohon se thëniet dhe deklaratat e ankuesit nuk kanë fuqi të argumenteve ligjore dhe nuk janë dëshmi për të i vërtetuar pretendimet e shfaqur. Tutje AKP-ja pohon se MEMO e nënshkruar është shkresë me karakter informues për blerësin e ri që nënkupton detyrimet e blerësit në caktimin e agjentit të regjistruar, ndërrimin e aksioneve të kompanisë ,adresën e kompanisë ,etj. dhe e njëjta nuk mund të përdoret ose të zëvendësoj kontratën e qirasë. AKP-ja pretendon se paditësi nuk ka mundur të ofroj prova për të i arsyetuar pretendimet se AKP-ja ka marrë këtë pjese të hapësirës me qira.DHPGJS-ja disa here ka kërkuar nga pala paditëse të ofroj prova bindjes se lokali është në shfrytëzim të paditurës si dhe qëndron në arsyetimin e Aktvendimit

me të cilin hedhet poshtë si e pa pranueshme pjesa e kërkesës për lirim të pronës se uzurpuar nga AKP-ja. AKP-ja pohon se paditësi nuk ka paraqitur ndonjë bazë të besueshme juridike dhe nuk ka vërtetuar ndonjë gjendjet tjetër faktike nga ajo që është dhënë në Aktvendimin e ankimuar. Nga këto arsye, AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor, andaj duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim për të vendosur lidhur me meritat e kërkesëpadisë.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në padinë e tij të dorëzuar në DHPGJS me datë 05 shkurt 2015 dhe në parashtresat e tij të mëvonshme të dorëzuara në DHPGJS në bazë të urdhrave të gjyqtarit përkatës të lendes, i ka dy kërkesa në padinë e tij. Kërkesa e parë e tij është kompensimi i fitimit të humbur në emër të shfrytëzimit të një hapësire të ndërtesës administrative nga ana e AKP-së në sipërfaqe prej 115 m², e cila sipërfaqe sipas paditësit shfrytëzohej nga AKP-ja e cila e mbante dokumentacionin arkivor të ndërmarrjes në këtë pjese të hapësirës se objektit, dhe kërkesa e dyte e tij është lirimi i kësaj pjese të hapësirës nga ana e AKP-së meqë ai e ka blerë këtë objekt të ndërmarrjes që nga viti 2005, dhe konsideron se me mbajtjen e këtij dokumentacioni arkivor nga ana e AKP-së ,ai nuk ka mundur ta shfrytëzoj këtë pjese të hapësirës. Paditësi përveç kontratës se shitblerjes të lidhur me AKM-në, MEMO në të cilën e mbështet kërkesëpadinë i ka

dorëzuar edhe kërkesa tjera dhe parashtresa dorëzuar AKP-së, si dhe një ekspertizë financiare dhe gjeodezike në bazë të së cilës është vlerësuar dëmi i pretenduar nga paditësi në emër të fitimit të humbur.

Kolegji i Apelit vëren se Kolegji i Shkallës së I-rë ka lëshuar disa urdhra për paditësin duke kërkuar nga paditësi të precizoj kërkesën e tij lidhur me kërkesën që ka të beje me lirim të pronës. Në përgjigje të këtyre urdhrave paditësi cdo here ka dorëzuar parashtresat e tij, në të cilat ai ka theksuar se çfarë është duke kërkuar nga Gjykata, dhe po ashtu me këto parashtresa ai vazhdimisht ka kërkuar nga Gjykata që të lirohet hapësira në ndërtesën administrative në sipërfaqe prej 115 m², dhe atë duke u bazuar në ekspertizën gjeodezike që ishte kryer me këtë rast.

Kolegji i Apelit nuk e ndan mendimin e Kolegjit të Shkallës së I-rë se paditësi nuk e ka precizuar mjaftueshëm kërkesëpadinë e tij lidhur me pjesën e lirit të pronës nga ana e AKP-së. Paditësi mjaftueshëm është orvatur ta precizoj kërkesëpadinë, madje në çdo urdhër të lëshuar ai është përgjigjur, dhe në mbështetje të kërkesës ai ka dorëzuar ekspertizën financiare dhe atë gjeodezike dhe kjo vlerësohet se është një punë që është kryer, e që i ka takuar paditësit ti mbështesë kërkesat e tij.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se Kolegji i Shkallës së I-rë me Aktvendimin e ankimuar ka vendosur pjesërisht lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, gjë që kjo nuk ishte e arsyeshme dhe as e nevojshme në këtë rast, pasi që ka lidhshmërinë reciproke të kërkesave të tij, të cilat paditësi i ka paraqitur në padinë e tij.

Ne bazë të nenit 143 par.2 të LPK-së " *Nëse në një padi janë përfshirë disa kërkesa ,Gjykata si rregull vendos për të gjitha kërkesat me një Aktgjykim të vetëm.*" Në këtë rast kjo gjë nuk ka ndodhur, edhe pse një gjë e e tille ishte e nevojshme të ndodhë.

Paditësi gjate procedurës me shkrim ka sjell prova të mjaftueshme me të cilat ai pretendon se i mbështet kërkesat e tij, dhe këto prova është e nevojshme të vlerësohen nga Gjykata e Shkallës së I-rë, gjë që në këtë rast me vendosjen e pjeshme, vlerësimi i provave nuk ka ndodh.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit nuk e mbështet rezultatin e dhënë me Aktvendimin e ankimuar, pasi që hedhja poshtë e padisë mbi bazën e pa pranueshmërisë, nuk ka mbështetje ligjore as në nenin 36 par.2 pika 2.5 të LDHP-së lidhur me nenin 102.3 të LPK-së.

Paditësi siç u tha me sipër, në të gjithë urdhrat e lëshuar nga gjykata ,ai është përgjigjur dhe në cdo përgjigje të tij ai ka paraqitur kërkesat e tij, që i ka me padi dhe këto kërkesa në bazë të provave të ofruar është dashtë të shqyrtohen në merita me një vendim gjyqësor.

Prandaj nga këto arsye Kolegji i Apelit konsideron se ankesa e paditësit është e bazuar, andaj duhet të anulohet Aktvendimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim, në mënyrë që Gjykata e Shkallës së I-rë në procedurën në vazhdim ti shqyrtoj dhe vlerësoj të gjitha provat që ekzistojnë në dosje, dhe të nxjerr edhe ndonjë provë tjetër nëse kjo është e domosdoshme, dhe pastaj me një vendim gjyqësor ti zgjidh të dy kërkesat e paditësit të paraqitur në padinë e tij, dhe në parashtrësat e tij të fundit.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e pa paguar taksën gjyqësore për procedurë ankimuar ne shumë prej 100 euro me datë 02 dhjetor 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 tetor 2023.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
